



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT
BORDI DREJTUES

Nr. 177/prot
13

Tiranë më 25/06/2024

PROCESVERBAL

MBLEDHJE BORDI

(Datë, 25/06/2024)

Të pranishëm nga Bordi Drejtues: Znj. Jonila Godole , Znj. Enriketa Pandelejmoni, Z. Vasil Tole, Z. Alfred Lako.

Të pranishëm nga Instituti : Z. Çelo Hoxha

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kolanës së librave 2024
2. Zgjedhjen e një anëtarit të Këshillit Shkencor për vendin vakant
3. Të ndryshme.

Hapet Mbledhja

(Mbledhja zhvillohet në ambientet e Institutit)

J. Godole: Përshëndetje . Fillojmë me rendin e ditës. Fillojmë me temën e parë me kolanën e vitit 2024. Matrialet na janë dërguar dhe i kemi shikuar. Fillojmë me diskutimin. Fjalën e ka Drejtori.

Ç. Hoxha: Ju kemi dërguar listën e librave për botim dhe ato të cilat nuk kanë kaluar nga për miratim nga Këshilli Shkencor. Kolana e rekomanduar për botim nga Këshilli Shkencor i ISKK, për vitin 2024, përfshin:

Studime shkencore: 3

Monografi: 1

Dokumente: 3

Memuaristikë: 5

Revista shkencore: 10 artikuj shkencorë.

E.Papa: Unë jam dakort me librat për miratim por kam kërkuar edhe diçka në lidhje me raportimin në Kuvend. Ajo që doja të theksoja për raportimin në Kuvend në komision duhet që kur të jetë koha e raportimit dhe vajtjes në Kuvend të jetë Bordi Drejtues bashkë me Drejtorin, pasi Bordi është institucioni drejtues i ISKK. Kjo u vu në vëmendje dhe në Kuvend , në komision.

J.Godole: Kush do ta marri fjalën, po Vaso.

V.Tole: Unë jam dakort me listën e librave dhe shof që më në fund procesi është në rregull..

A.Lako: Edhe unë i kam parë dhe jam dakort me listën e librave.

J.Godole: Edhe unë jam dakort me listën duke qënë se këto janë prorjet në institutit.

Votojmë listën e librave për botim?

V.Tole: Po dakort.

E.Papa: Po dakort.

A.Lako: Po dakort.

J.Godole: Lista e libra për botim për vitin 2024 miratohet.

Kalojmë të tema e dytë. Çelo ka propozuar znj.Fatmiroshe Xhemali për anëtare të Këshillit Shkencor, e cila është një bashkpuntore e vjetër e ISKK. Unë jam dakort që të jetë pjesë e Këshillit duke njohur punën e saj shumë vjeçare.

V.Tole: Unë doja të pyesja a ka master shkencor ne zonja? Unë do të apsenoj sepse në parim nuk e votoj dot pasi nuk e njoh.

J.Godole: Ajo është studiuse por ka edhe master shkencor sipas të dhënave që ka në CV e saj.

Ç.Hoxha: Unë e propozova duke u nisur nga puna e saj në fushën e historisë.

J.Godole: Fatmiroshe Xhemalaj është studiuese dhe është nder që të jetë pjesë e Institutit.

Ta hedhim në votim.

A.Lako: Po dakort jam.

E.Papa: Po dakort.

V.Tole: Dakort jam edhe unë meqënsë ka punuar në fushën e historisë.

J.Godole: Kalon edhe kjo miratohet.

V.Tole: Unë doja të pyesja pse nuk jeni kthyer te zyrat e institutit?

Ç.Hoxha: Zyrtarisht na kanë thënë se do të kualidohet , por nuk e dimë se çfarë po bëhet.

J.Godole: Ju falenderoj për pjesmarrjen dhe mbledhja mbyllet me miratimin e kolanës dhe me zgjedhjen e një anëtari të ri në Këshillin Shkencor.

Jonila Godole (Zv. Kryetar)

Vasil Tole (Anëtar)

Enriketa Pandlejmoni (Anëtar)

Alfred Lako (Anëtar)

Përpiloi

Lijana Aliko

